

TAKIMI I KATËRT 2024 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **16.12.2024**.

Në mbledhje u prezantua studimi i UNDP Albania për *“Ndikimin e digjitalizimit në sektorët prioritarë të ekonomisë: energji, TIK dhe turizëm”*.

Përfaqësuesi i UNDP Albania tha se, për mbledhjen e të dhënave ishte krijuar një sistem vlerësimi nga 0 në 100, mbi bazën e të cilit përcaktohej niveli i digjitalizimit të kompanive. U theksua se, kalimi i sektorëve në nivele më të larta digjitalizimi kërkonte profesione gjithnjë e më të zhvilluara dhe të avancuara në fushën e digjitalizimit dhe teknologjisë. Përfaqësuesi i UNDP Albania tha se, në atë moment po zhvillohej faza e mbledhjes së të dhënave dhe se projekti synonte të grumbullonte të dhëna nga 100 kompani në total nga tre sektorët, të ndara sipas peshës: turizmi 50%, TIK 30% dhe energjia 20%.

Në pjesën e dytë mbledhja u fokusua në prezantimin dhe diskutimin e kursit *“Aftësimi për përdorimin e teknologjive STEM dhe atyre të avancuara për formim profesional dhe punësim”*, të përgatitur nga CRCA. Përfaqësuesi i CRCA tha se, kurset ishin menduar si pjesë e një kurrikule të plotë, por që mund të zhvilloheshin edhe në mënyrë të pavarur. Çdo kurs ishte parashikuar të zgjaste 60 orë dhe të ofrohej fizikisht ose online. U sqarua se, dy nga kurset ishin teknike: *Programi i asistencës virtuale* dhe *Programi i programimit pa kod*, ndërsa dy të tjerat ishin të përgjithshme: *Programi i vetëpunësimit* dhe *Programi i fillimit të një plani biznesi*. Përfaqësuesi i CRCA tha se, kurset për vetëpunësimin dhe fillimin e biznesit mund të zhvilloheshin në çdo fushë, sipas interesit të të rinjve, me qëllim zhvillimin e aftësive shtesë për hapjen e një biznesi. Kursi do të ishte i hapur për të rinjtë nga 18 deri në 29 vjeç, me fokus arsimin profesional, pa kriter teknike për përfshirjen në STEM, me qëllim mbështetjen e të rinjve që nuk kishin aftësi apo mundësi të mjaftueshme fillestare. Të rinjtë do të pajiseshin me aftësi bazike gjatë kursit, ndërsa aftësimi real për punë do të realizohej më tej në biznes.

Nisur nga prezantimi i kursit, anëtarët validuan nevojën për zhvillimin e aftësive digjitale tek të rinjtë. Anëtarët dolën në konkluzionin se nisur nga përmbajtja e kursit mund të kishte dy forma të adresimit të tij:

- si kurs i unifikuar me katër module të pandashme dhe një certifikim të vetëm përfundimtar;
- si kurse të veçanta afatshkurtra të ofruara nga Qendrat e Formimit Profesional Publik, ku çdo kurs pajiset me një certifikatë.

Në pjesën e fundit të takimit u bë validimi i standardit të profesionit *“Asistent informacioni në mbështetje të përdoruesve të pajisjeve kompjuterike”*.

Sekretariati Teknik prezantoi funksionet dhe detyrat e standardit të profesionit: ***“Asistent informacioni në mbështetje të përdoruesve të pajisjeve kompjuterike”***. Pas diskutimeve mes anëtarëve për përmbajtjen e dokumentit, standardi u validua pa ndryshime.

Vendime të marra nga mbledhja

- U validua nevoja për zhvillimin e kursit ***“Aftësimi për përdorimin e teknologjive STEM dhe atyre të avancuara për formim profesional dhe punësim”***.
- U validua pa ndryshime standardi i profesionit: ***“Asistent informacioni në mbështetje të përdoruesve të pajisjeve kompjuterike”***.